



**Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council**

Këshilli Prokurorial i Kosovës, duke u bazuar në nenin 8, paragrafi 5 të Ligjit nr.06/L-009 për ndërmjetësim dhe nenin 7, paragrafi 1, nën paragrafi 1.31 të Ligjit nr.06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më datën 25 prill 2019, miraton këtë:

**RREGULLORE NR.04/2019  
PËR PROCEDURËN E NDËRMJETËSIMIT TË RASTEVE NGA PROKURORIA**

**KREU I  
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

**Neni 1  
Qëllimi**

Qëllimi i kësaj rregulloreje është që të përcaktohet procedura e referimit në ndërmjetësim të rasteve nga prokuroria.

**Neni 2  
Fushëveprimi**

1. Kjo rregullore zbatohet në tërë sistemin prokurorial të Kosovës, për veprat penale për të cilat parashihet dënimi me gjobë ose/dhe me burgim deri në tri (3) vjet për ndërmjetësim, në pajtim me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale, Ligjit nr.06/L-009 për ndërmjetësim dhe Kodit nr.06/L-006 të Drejtësisë për të Mitur.

2. Ndërmjetësimi nuk zbatohet për rastet që kanë të bëjnë me dhunën në familje.

**Neni 3  
Përkufizime**

1. Për qëllimet e kësaj rregulloreje, shprehjet e mëposhtme e kanë këtë kuptim:

1.1 Referenti për ndërmjetësim (referenti) – nënkupton zyrtarin e prokurorisë që administron rastet e referuara nga prokuroria.

1.2 Shprehjet e tjera të përdorura në këtë rregullore kanë kuptimin e njëjtë me përkufizimet e dhëna në Ligjin për ndërmjetësim.

## KREU II PROCEDURA E NDËRMJETËSIMIT PËR PERSONAT MADHORË

### Neni 4 Përshtatshmëria e rastit për ndërmjetësim

Prokurori i shtetit, para ngritjes së aktakuzës, mund të referojë rastin penal për ndërmjetësim për një veprë penale të dënueshme me gjobë ose me burgim deri në tri (3) vjet, e cila vlerësohet si e përshtatshme për ndërmjetësim, duke marrë parasysh llojin dhe natyrën e veprës, rrethanat në të cilat është kryer vepra, personalitetin e kryerësit, dënimet e mëparshme të tij për të njëjtin lloj të veprës penale apo për vepra penale të ndryshme, si dhe nivelin e përgjegjësisë penale të kryerësit të veprës penale.

### Neni 5 Procedura e referimit

1. Pasi që prokurori i shtetit vlerëson përshtatshmërinë e rastit merr vendim për referimin e atij rasti në procedurën e ndërmjetësimit.
2. Edhe palët mund t'i propozojnë prokurorit, me parashtresë ose gojarisht, që rasti i tyre të referohet në procedurën e ndërmjetësimit. Nëse prokurori vlerëson se rasti është i përshtatshëm, atëherë merr vendim për referim në ndërmjetësim.

### Neni 6 Menaxhimi i lëndës së referuar

1. Pasi që prokurori e referon lëndën në ndërmjetësim, referenti për ndërmjetësim i ndërmerr këta hapa:
  - a) E regjistron lëndën e referuar në Regjistrin e Lëndëve të Ndërmjetësimit me numër referues të ndërmjetësimit ( Nd.nr.--/----);
  - b) Në bazë të informacioneve që gjenden në shkresat e lëndës kontakton dhe informon palët për procedurën, parimet, afatin ligjor, efektin juridik të marrëveshjes, përzgjedhjen e ndërmjetësuesit dhe informata të tjera plotësuese;
  - c) Nëse palët japin pëlqimin për ndërmjetësim, atëherë referenti menaxhon me lëndën lidhur me përzgjedhjen e ndërmjetësuesit dhe seancat e ndërmjetësimit;
  - d) Nëse palët nuk japin pëlqimin të provojnë ndërmjetësimin ose fillimisht kanë dhënë një pëlqim të tillë, por nuk dëshirojnë të zhvillojnë procedurën e ndërmjetësimit, referenti brenda pesë (5) ditëve duhet ta njoftojë me shkrim prokurorin se palët kanë refuzuar ndërmjetësimin.

- e) Menaxhon me lëndët dhe orarin e seancave të ndërmjetësimit dhe
- f) Harton raportin mujor lidhur me ecurinë e lëndëve të referuara për ndërmjetësim dhe kujdeset për çështje të tjera administrative, që ndërlidhen me ndërmjetësimin.

#### **Neni 7**

#### **Përzgjedhja/caktimi i ndërmjetësuesit**

1. Referenti për ndërmjetësim iu ofron palëve mundësinë e përzgjedhjes së ndërmjetësuesit nga lista e ndërmjetësuesve të licencuar nga Ministria e Drejtësisë për rajonin që mbulon ajo prokurori. Referenti kontakton ndërmjetësuesin e përzgjedhur nga palët i cili duhet ta konfirmojë angazhimin e tij në rastin e referuar brenda tri (3) ditëve nga dita e thirrjes, në të kundërtën, referenti do të kontaktojë ndërmjetësues tjetër.
2. Nëse edhe ndërmjetësuesi tjetër nuk e konfirmon angazhimin e tij brenda afatit prej tri (3) ditëve nga dita e thirrjes, referenti për ndërmjetësim do ta caktojë ndërmjetësuesin tjetër sipas radhës nga lista e ndërmjetësuesve të rajonit që mbulon ajo prokurori.
3. Nëse palët pajtohen mund të angazhojnë dy ndërmjetësues në procesin e ndërmjetësimit (bashkëndërmjetësim).

#### **Neni 8**

#### **Fillimi i procedurës së ndërmjetësimit**

1. Referenti për ndërmjetësim është i obliguar që të bëjë identifikimin e palëve përmes dokumentit të identifikimit, të verifikojë autorizimin për përfaqësuesit e palëve nëse ka dhe përgatitë marrëveshjen për fillimin e procedurës së ndërmjetësimit, të cilën ua ofron palëve për nënshkrim.
2. Ndërmjetësuesi duhet t'i informojë palët për parimet, rregullat, shpenzimet e procedurës dhe efektet juridike të marrëveshjes.
3. Procedura e ndërmjetësimit fillon në datën kur palët nënshkruajnë marrëveshjen me shkrim për fillimin e procedurës së ndërmjetësimit dhe kanë 90 ditë kohë për të arritur marrëveshjen.
4. Nëse palët nuk mund të arrijnë marrëveshje brenda 90 ditëve, por sipas vlerësimit të ndërmjetësuesit ka gjasa që marrëveshja të arrihet, atëherë ky i fundit me kërkesë të arsyetuar mund t'i drejtohet prokurorit që ka referuar rastin për t'i lejuar një afat shtesë dhe të fundit prej tridhjetë (30) ditësh.
5. Prokurori mund ta lejojë afatin e tillë shtesë për arritjen e marrëveshjes nëse nga kjo kohë shtesë nuk shkaktohen pasoja ligjore në humbjen ose fitimin e të drejtave për njëren palë.

## **Neni 9**

### **Marrëveshja për fillimin e ndërmjetësimit**

1. Marrëveshja për fillimin e procedurës së ndërmjetësimit përmban këto të dhëna:
  - 1.1. Palët e dëmtuara ose përfaqësuesit e tyre, si dhe i pandehuri ose të pandehurit;
  - 1.2. Objektin e ndërmjetësimit;
  - 1.3. Deklaratën e pranimit të ndërmjetësimit dhe
  - 1.4. Shpenzimet e procedurës së ndërmjetësimit dhe tarifën e ndërmjetësuesit.
2. Në procedurën e ndërmjetësimit, i pandehuri si person fizik duhet të jetë i pranishëm personalisht apo përmes teknologjisë, ndërsa personi juridik përfaqësohet nga përfaqësuesi i autorizuar me autorizim të posaçëm.
3. Seancat e ndërmjetësimit mbahen në objektin e prokurorisë përkatëse. Përfundimisht, nëse palët dhe ndërmjetësuesi pajtohen, seancat mund të mbahen edhe në objekte të tjera të përshtatshme për ndërmjetësim, por për këtë duhet që paraprakisht ta njoftojnë referentën. Në këto raste, ndërmjetësuesi merr vetëm kopjet e shkresave të lëndës.
4. Ndërmjetësuesi lejohet të zhvillojë takime të ndara me secilën palë nëse ai konsideron se do të ishte në interesin më të mirë të palëve që të vazhdojnë procedurën e ndërmjetësimit dhe me qëllim të gjetjes së alternativave për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, por jo edhe vetë zgjidhjen përfundimtare.

## **Neni 10**

### **Konflikti i interesit**

Në rastet e konfliktit të interesit, ndërmjetësuesi është i obliguar të veprojë sipas dispozitës së nenit 18 të Ligjit për ndërmjetësim dhe dispozitave të tjera që rregullojnë fushëveprimtarinë e ndërmjetësuesit.

## **Neni 11**

### **Të metat e vullnetit**

Pa marrë parasysh se në çfarë faze gjendet procedura e ndërmjetësimit, nëse ndërmjetësuesi vëren se në mes palëve ka elemente të dhunës në familje apo ka të meta në shprehjen e vullnetit të lirë të palëve përmes dhunës ose kanosjes, ndërmjetësuesi duhet ta ndërpresë procedurën e ndërmjetësimit dhe të hartojë raportin për arsyet e ndërprerjes dhe duhet të kthejë lëndën te prokurori për procedurë të mëtejshme.

## **Neni 12**

### **Konfidencialiteti i informacioneve**

1. Procedura e ndërmjetësimit është e natyrës konfidenciale, seancat e ndërmjetësimit janë jopublike dhe gjatë tyre nuk mbahet procesverbal.
2. Deklaratat dhe të gjitha informacionet e tjera lidhur me procedurën e ndërmjetësimit nuk mund të publikohen, përveç nëse palët janë marrë vesh ndryshe.
3. Të gjitha subjektet e përfshira në procedurën e ndërmjetësimit janë të obliguara që të ruajnë konfidencialitetin dhe çdo informacion të ditur në procedurën e ndërmjetësimit, duke përfshirë të gjitha materialet e shkruara, përveç nëse palët janë marrë vesh ndryshe.

## **Neni 13**

### **Marrëveshja e arritur në ndërmjetësim**

1. Marrëveshja në ndërmjetësim arrihet dhe varet ekskluzivisht nga vullneti i lirë i palëve.
2. Kur palët arrijnë marrëveshje, ndërmjetësuesi harton marrëveshjen me shkrim, të cilën duhet ta nënshkruajnë palët dhe ndërmjetësuesi.
3. Marrëveshja është e detyrueshme për palët vetëm për objektin e marrëveshjes.
4. Marrëveshja duhet të jetë në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe e përshtatshme për përmbartim.
5. Marrëveshja e ndërmjetësimit e shkruar nga ndërmjetësuesi duhet të pasqyrojë qartë vullnetin e plotë të palëve dhe deklarimin e palëve lidhur me kompensimin e dëmit.
6. Nëse palët kanë vërejtje në marrëveshjen e shkruar nga ndërmjetësuesi, palët kanë të drejtë të kërkojnë nga ndërmjetësuesi i rastit ndryshimin ose përmirësimin e marrëveshjes së shkruar.

## **Neni 14**

### **Mosarritja e marrëveshjes**

Në rast se palët nuk arrijnë marrëveshje brenda afatit ligjor të ndërmjetësimit, ndërmjetësuesi përpilon raport me shkrim për arsyet e mosarritjes së marrëveshjes dhe ia dorëzon referentit, i cili së bashku me shkresat e tjera të lëndës ia kthen prokurorit të rastit për procedurë të mëtejme.

**Neni 15**  
**Përfundimi i procedurës së ndërmjetësimit**

1. Procedura e ndërmjetësimit përfundon me:
  - 1.1. Arritjen e marrëveshjes në mes të palëve;
  - 1.2. Tërheqjen e cilësdo palë, në çfarëdo kohe, gjatë zhvillimit të procedurës, duke deklaruar se nuk ka interes për vazhdimin e procedurës së ndërmjetësimit;
  - 1.3. Konfirmimin nga ana e ndërmjetësuesit për mosarritjen e marrëveshjes;
  - 1.4. Kalimin e afatit ligjor për arritjen e marrëveshjes dhe
  - 1.5. Anulimin e marrëveshjes.
2. Pas përfundimit të procedurës së ndërmjetësimit sipas paragrafit 1 të këtij neni, ndërmjetësuesi kthen lëndën te referenti, i cili kompletton dosjen e rastit dhe e kthen te prokurori i rastit për vazhdimin e procedurave ligjore të mëtuqjeshme.

**Neni 16**  
**Aprovimi ose anulimi i marrëveshjes së arritur në ndërmjetësim**

1. Marrëveshja e arritur në ndërmjetësim i dërgohet prokurorit, i cili pas vlerësimit të asaj marrëveshjeje, me aktvendim të veçantë e aprovon marrëveshjen dhe hedhë kallëzimin penal apo e pushon hetimin nëse ka marrë aktvendim për fillimin e hetimeve.
2. Marrëveshja dhe aktvendimi për pranimin e marrëveshjes së arritur me ndërmjetësim, i dërgohet kryeprokurorit të prokurorisë përkatëse, me ç'rast marrëveshja fiton fuqinë e vendimit të formës së prerë pas vënies së vulës së prokurorisë apo nënshkrimin e tij.
3. Prokurori që ka referuar rastin mund të anulojë marrëveshjen e arritur në ndërmjetësim, kur konstaton se është lidhur në kundërshtim me ligjin në fuqi dhe kur ka të meta të vullnetit.

**Neni 17**  
**Shpenzimet e procedurës**

**Te gjitha shpenzimet e procedurës së ndërmjetësimit do të paguhen proporcionalisht nga palët, përveç nëse janë marrë vesh ndryshe.**

**KREU III**  
**REFERIMI I RASTEVE TË TË MITURVE NË PROCEDURË TË**  
**NDËRMJETËSIMIT**

**Neni 18**

**Zbatimi i kësaj rregulloreje në rastet e të miturve**

Dispozitat e kësaj rregulloreje, të përmendura te Kreu II, përshtatshmërisht zbatohen edhe për të gjitha rastet e të miturve si kryerës të veprave penale dhe personave madhorë, që kanë kryer vepra penale ndaj fëmijëve për rastet penale ku është lejuar procedura e ndërmjetësimit.

**Neni 19**

**Përgjegjësitë e prokurorit për të mitur**

1. Prokurori i shtetit për të mitur mund të propozojë ndërmjetësimin nëse vlerëson se do të jetë më e përshtatshme, duke pasur parasysh natyrën e veprës penale, rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, historia e të miturit, mundësia e kthimit të raporteve normale në mes të miturit dhe palës së dëmtuar, mundësia e zvogëlimit të dëmit të palës së dëmtuar, mundësia e rehabilitimit të të miturit dhe riintegrimi i tij në shoqëri.
2. Para se palët të udhëzohen në procedurën e ndërmjetësimit, prokurori i shtetit për të mitur duhet t'i njoftojë palët për parimet dhe rregullat e ndërmjetësimit, si dhe për procesin dhe efektet ligjore të marrëveshjes që arrihet në ndërmjetësim në pajtim me Ligjin për ndërmjetësim dhe në përputhje me Kodin e Procedurës Penale.
3. Nëse palët pajtohen që rasti i tyre të shkojë në ndërmjetësim, prokurori i shtetit për të mitur merr vendim për referimin e rastit në ndërmjetësim dhe referenti menaxhon lëndën e referuar.
4. Prokurori, në kuptim të nenit 45 të Kodit të Drejtësisë për të Mitur, njofton organin e kujdestarisë dhe shërbimin sprovues me rrjedhën e procedurës së ndërmjetësimit.
5. I mituri me përfaqësuesin e tij ligjor dhe i dëmtuari mund të propozojnë procedurën e ndërmjetësimit.
6. Kur kryerësi i mitur dhe pala e dëmtuar shprehin pëlqimin e tyre personalisht apo përmes përfaqësuesve të tyre ligjor për ndërmjetësim, ky pëlqim duhet të shënohet në procesverbal.

**Neni 20**

**Përgjegjësitë e referentit për ndërmjetësim në rastet e të miturve**

Gjatë administrimit të rasteve të të miturve, referenti ka të njëjtat përgjegjësi të përcaktuara me dispozitat nga Kreu II i kësaj rregulloreje, përveç të drejtës për caktimin e ndërmjetësuesit në rast se palët nuk pajtohen për përzgjedhjen vullnetare të ndërmjetësuesit.

#### **Neni 21**

#### **Caktimi i ndërmjetësuesit për të mitur**

1. I mituri dhe pala e dëmtuar me marrëveshje mund të caktojnë ndërmjetësuesin.
2. Në rast se palët nuk pajtohen për përzgjedhjen e ndërmjetësuesit, atëherë prokurori i shtetit për të mitur me aktvendim e cakton ndërmjetësuesin nga lista e ndërmjetësuesve në pajtim me Ligjin për ndërmjetësimin dhe dispozitat e Kodit të Drejtësisë për të Mitur.
3. Pas pranimit të aktvendimit të prokurorit që cakton ndërmjetësuesin, referenti duhet që të vë në kontakt ndërmjetësuesin me kryerësin e mitur, përfaqësuesin e tij ligjor dhe palën e dëmtuar.

#### **Neni 22**

#### **Kohëzgjatja e procedurës së ndërmjetësimit për të mitur**

1. Procedura e ndërmjetësimit nuk mund të zgjasë më tepër se tridhjetë (30) ditë nga dita e nxjerrjes së aktvendimit të prokurorit për referimin e rastit në procedurë të ndërmjetësimit.
2. Për rezultatin e ndërmjetësimit njoftohet zyrtarisht prokurori i shtetit për të mitur.

#### **Neni 23**

#### **Përfundimi i procedurës së ndërmjetësimit**

1. Procedura e ndërmjetësimit në rastet e të miturve përfundohet atëherë kur:
  - 1.1. Është kryer me sukses ndërmjetësimi;
  - 1.2. Ka kaluar afati prej tridhjetë (30) ditësh;
  - 1.3. Ndërmjetësuesi konsideron se vazhdimi i procedurës së ndërmjetësimit nuk është i mundshëm ose është i paarsyeshëm;
  - 1.4. I mituri ose pala e dëmtuar deklarojnë se dëshirojnë ta ndërpresin procedurën me anulimin e marrëveshjes.
2. Kur ndërmjetësimi nuk ka sukses, prokurori i shtetit për të mitur, i cili ka propozuar ndërmjetësimin, me aktvendim rifillon procedurën e pezulluar nga momenti i pezullimit të saj.
3. Marrëveshja e arritur në ndërmjetësim, i dërgohet prokurorit për të mitur që ka referuar rastin, i cili pas vlerësimit të asaj marrëveshjeje, me aktvendim të veçantë e aprovon



marrëveshjen dhe hedhë kallëzimin penal ose pushon procedurën përgatitore nëse ka aktvendim për fillimin e procedurës përgatitore dhe prokurori i shtetit për të mitur duhet t'i njoftojë palët lidhur me vendimin e tij dhe nga ky moment marrëveshja e ndërmjetësimit bëhet e formës së prerë.

4. Prokurori që ka referuar rastin mund ta anulojë marrëveshjen e arritur në ndërmjetësim, kur konstaton se është lidhur në kundërshtim me ligjin në fuqi dhe kur ka të meta të vullnetit.
5. Në aktvendimin për hedhje të kallëzimit penal ose për pushimin e procedurës përgatitore, prokurori i rastit për të mitur do të konstatojë se i mituri apo personi madhor që ka kryer veprën penale ndaj fëmijës të fshihet nga evidenca e personave, ndaj të cilëve është zhvilluar procedura penale.

#### **Neni 24**

##### **Përfshirja e ndërmjetësimit për të mitur**

1. Dispozitat për përfshirjen e gjyqtarit apo prokurorit të përcaktuar në Kodin e Procedurës Penale zbatohen përshtatshmërisht edhe për përfshirjen e ndërmjetësimit për të mitur. Ankesa kundër aktvendimit të prokurorit nuk lejohet, me të cilin vendoset për kërkesën për përfshirje.
2. Përfshirja e ndërmjetësimit mund të kërkojë nga i mituri, prindi, prindi adoptues, kujdestari, avokati mbrojtës dhe pala e dëmtuar.
3. Kërkesa për përfshirje duhet të vendoset nga prokurori i rastit, i cili e ka caktuar ndërmjetësin.

#### **Neni 25**

##### **Shpenzimet e procedurës së ndërmjetësimit për të mitur**

1. Procedura e ndërmjetësimit për të mitur si parim është pa pagesë për palët, përveç nëse palët janë marr vesh ndryshe.
2. Shpenzimet e procedurës së ndërmjetësimit, duke përfshirë pagesën për ndërmjetësin, në rastet kur ndërmjetësi caktohet nga prokurori i shtetit për të mitur, shpenzimet e procedurës paguhen nga buxheti i Këshillit Prokurorial të Kosovës.

#### **Neni 26**

##### **Dosja e lëndës**

1. Marrëveshja e arritur në ndërmjetësim nënshkruhet në tri (3) kopje, një për secilën palë dhe një bëhet pjesë e shkresave të lëndës së referuar dhe i dorëzohet prokurorit.
2. Formularët që janë pjesë e kësaj rregulloreje që përdoren gjatë procedurës së ndërmjetësimit bëhen pjesë e dosjes së lëndës dhe i dërgohen prokurorit.
3. Arkivimi i lëndës bëhet sipas procedurës së paraparë për arkivimin e lëndëve të prokurorisë.

**Neni 27**  
**Shfuqizimi**

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohet vendimi për referimin e lëndëve nga prokuroritë publike te qendrat e ndërmjetësimit, i miratuar nga Këshilli Prokurorial i Kosovës me Vendimin numër KPK.Nr.80/2013, të datës 22 mars 2013.

**Neni 28**  
**Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryesuesi i Këshillit.

Prishtinë, më datë:

03-06-2019

  
**Bahri HYSENI**  
Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës

